



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT**

NJOFTIM

PËR

**SHPLLJEN E TRE VENDEVE VAKANT PËR
KOMISIONER NË INSTITUCIONIN E AVOKATIT TË POPULLIT**

Në zbatim të nenit 33/1, pika 4 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, Institucioni i Avokatit të Popullit shpall konkurimin për 3 (tre) vende vakant për Komisioner dhe konkretisht:

- ✓ *Komisioner në Seksionin e organeve të administratës qendrore, të pushtetit vendor dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të tyre*
- ✓ *Komisioner në Seksionin për policinë, shërbimin sekret, burgjet, forcat e armatosura dhe pushtetin gjyqësor*
- ✓ *Komisioner në Seksionin e përgjithshëm (Objekt i veprimtarisë të të cilit është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të grupeve vulnerable si dhe trajtimi i çështjeve që lidhen me arsimin dhe kujdesin shëndetësor)*

Sipas nenit 33, pika 1, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të kenë mbaruar arsimin e lartë juridik, diplomë / “Master shkencor” ose tituj të ekuivalentuar me të
- Të kenë vjetërsi në profesion si jurist jo më pak se 10 vjet
- Të mos jenë të dënuar penalisht me vendim të formës së prerë
- Të mos jenë anëtarë të partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër

Po sipas nenit 31, pika 2, të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, kandidati që përmbush kushtet e mësipërme ligjore, do të zgjidhet Komisioner edhe në bazë të plotësimit të këtyre kriterëve objektive:

- Vjetërsisë në profesion
- Ecurisë gjatë kryerjes së arsimit të lartë dhe gëzimit të titujve shkencorë
- Njohurive të thelluara dhe/ose kualifikimit në fushën e lirive dhe të drejtave të njeriut dhe të ligjit
- Veprimtarisë së njohur në opinionin publik, në mbrojtjen dhe nxitjen e respektimit të të drejtave dhe lirive të shtetasve
- Të gëzojë integritet të lartë moral dhe figurë të pastër etiko-morale

Paraqitja e dokumentacionit

Brenda datës **24 shtator 2018**, kandidatët duhet të paraqesin dokumentat pranë institucionit të Avokatit të Popullit. Dokumentat duhet të përmbajnë:

- Kërkesën për shprehje interesi të specifikuar për cilin Seksion do të aplikojë
- CV-në
- Fotokopje e Librezës së punës
- Diplomën që provon se ka mbaruar arsimin e lartë juridik, “Master shkencor” ose tituj të ekuivalentuar me të, si dhe çdo dokument tjetër që provon thellimin e njohurive. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit duhet të jenë të njohura paraprakisht para institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave sipas legjilacionit në fuqi
- Dokument që vërteton njohjen e gjuhës së huaj (anglisht dhe/ose frengjisht)
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore që vërteton se nuk ka qënë i dënuar penalisht
- Deklaratë për mosqenien anëtar i partive politike, deputet, ministër, zëvendësministër
- Plotësimin dhe nënshkrimin e Formularit të vetëdeklarimit në zbatim të ligjit nr.138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (Këtë Formular e gjeni në adresën zyrtare të AP www.avokatipopullit.gov.al).
- Plotësimin dhe nënshkrimin e Formularit- Tip të Aplikimit, sipas ligjit 45/2015, “Për të Drejtën e Informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë” (Këtë Formular e gjeni në adresën zyrtare të AP www.avokatipopullit.gov.al)
- Deklaratë të nënshkruar prej tij, me të cilin aplikuesi deklaron vërtetësinë e dokumentave të paraqitura

Gjatë procesit të shqyrtimit të dokumentacionit, mund të kërkohen dhe dokumenta shtesë në funksion të vërtetueshmërisë të plotësimin të kriterëve ligjore të përmendura më sipër.

Paga

Paga për pozicionin e Komisionerit është sa dy të tretat e pagës së Avokatit të Popullit. Sipas nenit 6 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, paga e Avokatit të Popullit barazohet me atë të Kryetarit të Gjykatës së Lartë.

Aplikimi

Aplikimet duhet të dërgohen në zarf të mbyllur në adresën:

*Institucioni i Avokatit të Popullit
Blv. "Zhan D'Ark", nr.2, Tiranë, Shqipëri*

Në dosjen e aplikimit, përveç dokumenteve të kërkuara, kandidati duhet të japë adresën e saktë të vendbanimit si dhe një numër telefoni (Fiks apo mobile).

Afati

Aplikimet pranohen deri në datë **24 shtator 2018, ora 16:30**. Do të shqyrtohen vetëm ato aplikime që mbërrijnë brenda këtij afati. Pas vlerësimit të dokumentave vetëm kandidatët e suksesshëm do të ftohen për intervistë, ndërkohë që kandidatët që nuk i plotësojnë kriteret ligjore, do të njoftohen zyrtarisht për arsyet e skualifikimit.

Për çdo sqarim apo paqartësi në lidhje me këtë process aplikimi, mund të kontaktoni në numrin e tel: 0683143696, ose në adresën elektronike: msanxhaku@avokatipopullit.gov.al

Suksese!